VENDIM
Nr. 156, datë 9.7.2018

MBI PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "EFT ALBANIA" SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 42, pika 1, germa "dh", të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar; të nenit 5, germa "dh"; të nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë "EFT Albania" sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 14.11.2014, ka licencuar shoqërinë "EFT Albania" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria "EFT Albania" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 487 prot., datë 3.0.2018, ka kërkuar nën vullnetin e saj të plotë heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa e shoqërisë "EFT Albania" sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, germa "dh", "Heqja e një licence", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të nenit 5, germa "dh", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

Subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet qe lidhen me pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "EFT Albania" sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit me energji elektrike, me nr. 255, seria T14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 14.11.2014.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë kërkuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti